

**LIGJI Nr. 04/L-078
PËR SIGURINË E PËRGJITHSHME TË PRODUKTEVE**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR SIGURINË E PËRGJITHSHME TË PRODUKTEVE

**Neni 1
Qëllimi**

- 1.Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë që produktet e vendosura në treg të jenë të sigurta.
- 2.Me këtë ligj përcaktohen kërkesat për sigurinë e përgjithshme të produkteve, detyrimet e prodhuesve dhe shpërndarësve, informimin e publikut, nxitjen e masave vullnetare si dhe mbikëqyrjen ndaj përmbushjes së kërkesave të përcaktuara me këtë ligj.

**Neni 2
Fusha e Zbatimit**

- 1.Ky ligj zbatohet për të gjitha produktet sikurse përkufizohen në këtë ligj. Dispozitat e këtij ligji zbatohen nëse nuk ka dispozita të tjera specifike po për këtë qëllim në legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë.
- 2.Nëse ka dispozita të veçanta që rregullojnë kërkesat e sigurisë për produkte të caktuara, atëherë ky ligj zbatohet vetëm për ato aspekte dhe rreziqe apo kategori rreziqesh që nuk mbulohen nga ato dispozita.

**Neni 3
Përkufizimet**

- 1.Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
 - 1.1.**Ministria** - Ministria Përkatëse e Tregtisë dhe Industrisë.
 - 1.2. **Ministër** - Ministri përkatës i Tregtisë dhe Industrisë.
 - 1.3.**Produkt** – çdo produkt, përfshirë edhe ato në kontekstin e ofrimit të një shërbimi që është i destinuar për konsumatorët ose që në mënyre të arsyeshme mund të përdoret nga konsumatorët edhe pse jo i destinuar për ta, dhe që është vendosur në treg ose është i gatshëm për përdorim, me pagesë ose jo, në kuadër të një aktiviteti tregtar, pavarësisht nëse është i ri, i përdorur ose i përpunuar. Ky përkufizim nuk përfshin produktet e përdorura të cilat furnizohen si antika ose për riparim apo për përpunim para se të përdoren, me kusht që furnizuesi e informon qartë personin që e merr produktin në lidhje me këtë.
 - 1.4.**Produkt i sigurt** – çdo produkt i cili, në kushtet normale apo arsyeshëm të parashikueshme të përdorimit, duke përfshirë kohëzgjatjen, sipas rastit vendosjen në përdorim, kërkesat për instalim dhe mirëmbajtje, nuk paraqet asnjë rrezik ose vetëm rreziqet minimale në përputhje me përdorimin e produktit e që konsiderohen të pranueshme dhe konsistente me nivelin e lartë të

mbrojtjes për sigurinë dhe shëndetin e njerëzve, në veçanti duke marrë parasysh elementet e mëposhtme 1.4.1. deri 1.4.4. Fakti se mund të arrihen nivele më të larta sigurie apo se ka produkte të tjera më pak të rrezikshme nuk janë arsye për ta konsideruar një produkt “të rrezikshëm”.

1.4.1.karakteristikat e produktit, përbërja e tij, paketimi, udhëzimet për montim dhe sipas nevojës për instalim dhe mirëmbajtje;

1.4.2.ndikimi i tij në produkte të tjera, kur arsyeshëm parashikohet që ai do të përdoret me produkte të tjera;

1.4.3.prezantimi i produktit, shënjimi i tij, vërejtjet dhe udhëzimet për përdorimin e tij, vendosjen dhe hedhjen apo asgjësimin pas përdorimit të tij si dhe të gjitha llojet e shenjave tjera ose informatat për atë produkt;

1.4.4.kategoritë e konsumatorëve të cilat i ekspozohen rrezikut kur përdorin një produkt të caktuar, veçanërisht fëmijët dhe të moshuarit.

1.5.Produkt i rrezikshëm - çdo produkt që nuk është në përputhje me përkufizimin në nën-paragrafin 1.4. të këtij neni.

1.6.Rrezik serioz - çdo rrezik i cili kërkon intervenim të shpejtë të organit kompetent shtetëror, përfshirë edhe rrezikun pasojat e të cilit nuk janë të menjëhershme.

1.7.Prodhues – nënkupton:

1.7.1.prodhuesin e produktit i cili ka selinë në Republikën e Kosovës dhe çdo person juridik ose fizik i cili paraqitet si prodhues, që vendos në produkt emrin e tij, markën tregtare të tij apo ndonjë shenjë tjetër dalluese, ose ai i cili e përpunon produktin;

1.7.2.përfaqësuesi i prodhuesit kur prodhuesi nuk ka seli në Republikën e Kosovës, e kur nuk ka përfaqësues, importuesi i produktit;

1.7.3.çdo person tjetër në zinxhirin e furnizimit, aktiviteti i të cilit mund të ndikojë në karakteristikat e sigurisë së produktit.

1.8.Shpërndarës – çdo person juridik ose fizik tjetër në zinxhirin e furnizimit, aktiviteti i të cilit nuk ndikon në karakteristikat e sigurisë së produktit.

1.9.Kthimi i produktit - çdo masë që synon të arrijë kthimin e produkteve të rrezikshme që janë shpërndarë tashmë apo u janë dërguar konsumatorëve nga prodhuesi ose shpërndarësi;

1.10.Tërheqja e produktit - çdo masë të ndërmarr qëllimi i së cilës është ndërprerja e shpërndarjes, ekspozimit ose ofrimit të produktit të rrezikshëm.

1.11.Imitim i rrezikshëm i produktit- produkti me dukje mashtruese, që nuk është ushqim, por ka formë, erë, ngjyrë, dukje të jashtme, ambalazh, shenjë, vëllim ose madhësi për të cilat konsumatorët në veçanti fëmijët i vë në konfuzion për të zëvendësuar atë me ushqim dhe për shkak të kësaj e vënë në gojë ose e gëlltisnin, që mund të paraqet rrezik dhe të shkaktojë, ngulfatje helmim ose edhe pengesa në traktin e tretjes.

1.12.Standardi i harmonizuar evropian - standardi i miratuar në bazë të mandatit të Komisionit Evropian, të dhënat referuese të të cilit publikohen në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

1.13. **Standard i Kosovës - "SK"** - një standard i cili është në dispozicion të publikut e që është miratuar nga Agjencia Kosovare e Standardizimit.

Neni 4

Kërkesat e përgjithshme për sigurinë e produkteve

1. Prodhuesi është i detyruar të vendosë në treg vetëm produkte të sigurta.
2. Produkti konsiderohet i sigurt kur plotëson standardet për sigurinë e produkteve sikurse kërkohet nga legjislacioni aktual në Republikën e Kosovës për sigurinë dhe konformitetin e produkteve.
3. Produkti konsiderohet i sigurt për sa i përket rreziqeve dhe kategorive të rreziqeve, nëse plotëson kushtet e përcaktuara në përputhje me standardet e BE-së dhe që janë adoptuar si Standarde Kosovare, SK. Lista e tyre publikohet në faqen zyrtare të MTI-së. MTI është përgjegjëse për përditësim e kësaj liste.
4. Konformiteti i një produkti me kriteret e përcaktuara për të plotësuar kërkesat e përgjithshme të sigurisë nuk duhet t'i pengojë autoritetet kompetente të vendosin kufizime për vendosjen e tij në treg apo të kërkojnë edhe tërheqjen apo kthimin kur ka prova se është i rrezikshëm pavarësisht nga konformiteti.

Neni 5

Detyrimet e prodhuesve dhe shpërndarësve

1. Brenda fushës së aktivitetit të tyre, prodhuesit:

1.1. duhet t'i japin konsumatorëve dhe përdoruesve të tjerë informacionin e nevojshëm në mënyrë që konsumatorët dhe përdoruesit e tjerë të mund të vlerësojnë rreziqet që mbart produkti gjatë kohës normale apo arsyeshëm të parashikueshme të përdorimit, kur këto rreziqe nuk janë të qarta pa paralajmërimin adekuat dhe të marrin masa kundër këtyre rreziqeve;

1.2. në përputhje me karakteristikat e produkteve të cilat i ofrojnë, marrin masa që u mundësojnë atyre informim me kohë për rrezikun që mund të paraqesin produktet, dhe sipas nevojës tërheqin produktet nga tregu ose kthimin e produkteve nga konsumatorët në mënyrë që të shmangen rreziqet;

1.3. marrin masa për kthim të produkteve nga konsumatorët vetëm si mjetin e fundit, kur masat e tjera nuk janë të mjaftueshme për të parandaluar rreziqet e caktuara, kur prodhuesit e konsiderojnë të domosdoshme ose kur ata janë të detyruar të veprojnë sipas masave të ndërmarra nga organet kompetente.

2. Masat e referuara në paragrafin 1. nën-paragrafi 1.2. të këtij neni përfshijnë:

2.1. vendosjen e të dhënave për identitetin dhe detajet e prodhuesit në produkt ose në ambalazhin e tij si dhe shënjimimin e produktit ashtu që të mund të identifikohen qartë;

2.2. kryerjen e testeve të mostrave të produkteve të cilat janë vendosur në treg në të gjitha rastet kur është e nevojshme, shqyrtimin e ankesave me shkrim, mbajtja e regjistrit për ankesat me shkrim si dhe informimi i shpërndarësve për aktivitetet e ndërmarra.

3. Aktivitetet e përcaktuara në paragrafin 2. nën-paragrafi 2.2. të këtij neni prodhuesit duhet t'i ndërmarrin vullnetarisht ose me kërkesë të organit kompetent sipas nenit 8 të këtij ligji.

4. Informimi sipas paragrafit 1. nën-paragrafit 1.1. të këtij neni nuk i liron prodhuesit nga përmbushja e detyrimeve të tjera të përcaktuara me këtë ligj.

5. Shpërndarësit duhet të veprojnë me kujdesin e duhur në mënyrë që produktet të plotësojnë kërkesat e sigurisë. Shpërndarësit nuk duhet të ofrojnë produkte për të cilat e dinë ose duhet të dinin në bazë të të dhënave që ata posedojnë si profesionistë se nuk i plotësojnë kërkesat e sigurisë. Brenda fushës së aktivitetit të tyre, shpërndarësit duhet të marrin pjesë në monitorimin e sigurisë së produkteve të vendosura në treg, të shkëmbejnë dhe transmetojnë informacionet për rreziqet e produkteve, të ruajnë dhe të ofrojnë dokumentet e nevojshme për verifikimin e origjinës së produkteve dhe të bashkëpunojnë me organet kompetente dhe prodhuesit për marrjen e masave për parandalimin e rreziqeve.

6. Kur prodhuesit dhe shpërndarësit e dinë ose duhet të dinin, bazuar në të dhënat që posedojnë, se produkti që kanë vendosur në treg paraqet për konsumatorët rrezik që nuk është në përputhje me kërkesat e përgjithshme të sigurisë, duhet menjëherë të njoftojnë organet kompetente për rrezikun, si dhe për masat që kanë ndërmarrë për të parandaluar rrezikun për konsumatorët.

7. Në qoftë se prodhuesit dhe shpërndarësit vlerësojnë se ekziston rreziku serioz, njoftimi i përcaktuar në paragrafin 6. të këtij neni duhet të përmbajë:

7.1. të dhënat që mundësojnë identifikimin e produktit ose serinë e tij;

7.2. përshkrimin e plotë të rrezikut që paraqet ai produkt;

7.3. të gjitha informatat e nevojshme që disponohen për përcjellje të produktit;

7.4. përshkrimin e aktiviteteve të ndërmarra për të parandaluar rrezikun ndaj konsumatorëve.

8. Në marrjen e masave për të shmangur rreziqet që paraqiten nga produktet të cilat janë vendosur apo janë duke u vendosur në treg prodhuesit dhe shpërndarësit janë të detyruar të bashkëpunojnë me organet kompetente sipas procedurave që janë vendosur nga Ministria dhe në legjislacionin përkatës në fuqi.

9. Komunikimi dhe njoftimet që prodhuesit dhe shpërndarësit i dërgojnë organeve kompetente rregullohen nga legjislacioni në fuqi dhe nga Ministria me akte nënligjore.

Neni 6

Nxitja e Masave Vullnetare

Organi kompetent për mbikëqyrjen e sigurisë së përgjithshme të produkteve në mënyrë sistematike nxit prodhuesit dhe shpërndarësit që të bëjnë veprime vullnetare në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe mbështet krijimin e rregullave të praktikës së mirë në sektorë të caktuar të sigurisë së produkteve me qëllim të vendosjes së produkteve të sigurta në treg.

Neni 7

Informimi i publikut dhe shkëmbimi i informacionit në situatat e ndërhyrjes së shpejtë

1. Informimi i publikut mbi produktet e rrezikshme është përgjegjësi e organit kompetent në Ministri.

2. Procedura dhe mënyra e informimit të publikut lidhur me produktet e rrezikshme rregullohet me akt nënligjor duke pasur parasysh:

2.1. të drejtën e publikut për tu informuar;

2.2. rëndësinë e informimit të publikut për produktet e rrezikshme;

2.3. ruajtjen e sekretit të punës.

3. Informacionet që kanë të bëjnë me karakteristikat e sigurisë së produkteve të cilat duhet të jenë në dispozicion të publikut, me qëllim që të mbrohet shëndeti dhe siguria e konsumatorëve nuk mund të konsiderohen sekret i punës.

4. Shkëmbimi i informacionit për sigurinë e përgjithshme të produkteve dhe aktet nënligjore përkatëse do të jenë në përputhje edhe me legjislacionin aktual në Republikën e Kosovës që mbulojnë çështje të caktuara për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së konsumatorëve.

5. Me qëllim që të sigurohet mbikëqyrja efektive e tregut për të siguruar nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë së konsumatorëve, Ministria do të nxjerrë aktet nënligjore që përcaktojnë procedurat e informimit dhe të shkëmbimit të informacionit me organet e tjera të administratës shtetërore dhe të subjekteve ndërkombëtare lidhur me:

5.1. shkëmbimin e informacioneve për vlerësimin e rreziqeve, produktet e rrezikshme, metodat e testimit;

5.2. vendosjen e mbikëqyrjes dhe të procedurave të përbashkëta të testimit;

5.3. masat që janë marrë kur janë evidentuar produktet e rrezikshme;

5.4. ndërhyrjet që janë bërë ose që duhen bërë menjëherë sipas nivelit të rrezikut dhe pasojat e mundshme.

Neni 8 Mbikëqyrja

Mbikëqyrja inspektuese e këtij ligji kryhet nga Inspektorati i Tregut në përputhje me kompetencat dhe detyrimet siç rregullohen nga legjislacioni në fuqi për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut.

Neni 9 Dispozitat ndëshkuese

Dënimet dhe gjobat përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut.

Neni 10 Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij ligji do të nxjerrë akte nënligjore në afat prej dymbëdhjetë (12) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 11 Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji Nr. 02/L-21 Për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve.

Neni 12 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/ L-078
21 dhjetor 2011**

Shpallur me dekretin Nr. DL-054-2011, datë 30.12.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.